

Katalogu i lektyrave shkollore




LEKTYRAT 1-5

Seria e lektyrave shkollore për klasat 1-5 ka pasur një qëllim të thjeshtë: t'i ndihmojë fëmijët të zbulojnë kënaqësinë e vërtetë të leximit. Librat që kemi përzgjedhur përfshijnë aventura, përralla, poezi e histori interesante që hapin dritare të reja në mendjen e tyre.

Në këtë seri kemi përfshirë autorë shqiptarë e botërorë, nga ata që janë dashur e lexuar nga fëmijët e gjithë botës.



Për mësuesit, këto lektyra janë mbështetje e çmueshme në klasë: tekstet nxisin biseda mes nxënësish, të menduarit e tyre dhe i lidhin ata me përditshmërinë. Për prindërit, janë mënyra e duhur për të krijuar te fëmijët e tyre një shprehje që do t'i shoqërojë gjithë jetën: leximin e librave më të mirë.



Aparatura

Çdo lektyrë shoqërohet me një aparaturë didaktike të punuar me kujdes, ku fëmijët gjejnë pyetje të thjeshta - por domethënëse - dhe ushtrime e situata që i nxisin të reflektojnë, të mendojnë e të krijojnë. Aparatura didaktike i mëson fëmijët se si lexohet një libër, si kuptohet ai, si dhe pasuron imagjinatën e tyre.



7. Nëse do të ekzistonte një ilaç i tillë që do të të rriste dhe do të të zvogëlonte sipas dëshirës sate, a do ta përdorje atë?

8. Liza, pasi zvogëlohet, bie në pellgun e lotëve. Pse e ka këtë emër?

9. Lexoje me kujdes këtë fjali.

Pikërisht atëherë dëgjoi diçka, pak më larg, që pllajqiste këmbët dhe Liza iu afrua me lutje për të parë se çfarë ishte. Çfarë pa Liza?

- a) Një hipopotam;
- b) Një lopë deti;
- c) Një mi.

10. Si përshkruhet Macja e Zgërdheshur në libër?

- a) Ajo është një kotele e vogël, e bardhë me sy të kaltër;
- b) Ajo është një mace e madhe, me vija dhe me një buzëqeshje djallëzore;
- c) Ajo është një mace e vogël, e zezë me sy të kaltër.

11. Çfarë aftësie të veçantë ka Macja në libër?

- a) Ajo flet shumë gjuhë;
- b) Ajo mund ta parashikojë të ardhmen;
- c) Ajo mund të shfaqet e të zhduket sipas dëshirës.



didaktike



Për mësuesit dhe prindërit, aparatura didaktike është ndihmesë e madhe, sepse u ofron mënyra të natyrshme për të biseduar me fëmijët, për t'i nxitur t'i shprehin mendimet e tyre dhe për t'i përfshirë më shumë në procesin e leximit.

12. Sa ishte brenda pellgut të lotëve, Liza sheh edhe shumë kafshë të tjera. Me kë takohet ajo? Përmend disa nga kafshët dhe përshkruaj se si duken ato.



13. Cili është emri i vërtetë i Mbretëreshës?

- a) Mbretëresha e Zemëruar;
- b) Mbretëresha e Bardhë;
- c) Mbretëresha Kupë.

14. Liza merr pjesë në një festë çaji. Cilat janë disa nga rregullat që ajo duhet t'i ndjekë?

15. Çfarë loje luan Mbretëresha me flamingot dhe iriqët? (Përshkruaj lojën dhe rregullat e saj.)

- a) Futboll;
- b) Krokët;
- c) Tenis.



Fjalorthi

Duke qenë se pasurimi i fjalorit është një nga qëllimet kryesore të leximit të lektyrave, në tekst janë lënë qëllimshëm disa fjalë të reja, të shënuara me *italic*. Përkrah tyre, në anë të faqes, jepet shpjegimi i thjeshtë dhe i kuptueshëm, në mënyrë që fëmijët të mos hasin vështirësi në të kuptuarit dhe, njëkohësisht, të pasurojnë leksikun e tyre mendor.





pas u shfaq një kokë me flokë bionde dhe një trup i vogël, i lehtë e i brishtë, në një kostum të bardhë. Ai që doli nga zambaku ishte një njeri shumë i vogël.

Askush nuk do të ishte aq i zoti sa të mund të përshkruante tronditjen dhe kënaqësinë e Majës së vogël. Ajo u ul si e ngritë dhe nuk mundi të shikonte sytë nga pamja që kishte përpara.

*Mikroskopike -
(fig.) me
përmasa
shumë të
vogla*

Ajo njerëzore mikroskopike u ngjit nëpër petal deri lart në kuroren e majës së vogël. Ajo u ul në një krah të krahës së saj të vegjël kundrejt dritës së hënës dhe pa me një kënaqësi natën e shndritshme të planetit të njerëzve. Pastaj u ngrit dhe shikoi lehtë trupin e tejdukshëm dhe, befasi, dy krahë të shndritshëm u hapën nga supet, më të bardhë se drita e hënës dhe të pastër si drita e saj. Ajo u ngritën përmbi kokën bionde dhe u ulën poshtë deri në krahët e saj. Maja e vogël nuk kishte parë kurrë diçka kaq të këndshme si kjo. Dhe, ndërsa qenia e vogël njerëzore që shndrite qëniet e tjerë dhe shikonte duart drejt qiellit, zeri i saj i lartë u dëgjua përseri dhe u shpërndajë si fjalet e këngës që buçiste në mes të natës.

*Vendlindja ime është drita,
qielli i kalter, gezimi im,
jeta i të vendit vdekës,
por kjo s'ndodh me shpirtin tim.*

*Shpirti është fryma ime,
tejkalon çdo bukuri
dos nuk shohim fytyrën e Zotit,
por e ndiejmë që është aty.*



Ilustrimet origjinale

Ilustrimet e këtyre lektyrave janë krijuar veçanërisht për botimet e kësaj serie, me një stil artistik origjinal që u jep gjallëri ngjarjeve që rrëfehen. Çdo faqe është punuar me kujdes të veçantë, duke pasur parasysh moshën dhe botën emocionale të fëmijëve. Ngjyrat, kompozimi dhe detajet vizuale e bëjnë leximin më të gjallë, më të prekshëm dhe më emocionues - një eksperiencë që i lidh fëmijët menjëherë me librin dhe i mban aktivë deri në faqen e fundit.





Paleta e ngjyrave është përzgjedhur me shumë kujdes: për shembull, ngjyra e zezë është eliminuar pothuajse krejtësisht në librat e klasave 1 dhe 2, për t'u dhënë fëmijëve një atmosferë më të butë, më të ngrohtë dhe vizualisht më tërheqëse.

Klasa e parë

Seria e lektyrave shkollore për klasën e parë përbëhet nga pesë tituj, që kombinojnë autorët më të famshëm botërorë për fëmijë me ata shqiptarë. Secili libër përmban aparaturën didaktike e fjalorthin shpjegues, të cilët i ndihmojnë fëmijët ta kuptojnë përmbajtjen dhe t'i përmirësojnë aftësitë e tyre gjuhësore, si dhe ilustrime origjinale për ta bërë më të këndshëm leximin.







Autore: Beatrix Potter
Përktheu: Orjela Stafasani

Tregimi i lepurit Piter

Një histori e paharrueshme që i mëson fëmijët të marrin vendime të mençura, ndërsa i fut në botën plot aventura të lepurit Piter! Në këtë libër klasik të lexuar gjithandej nëpër botë, Beatrix Potter-i sjell aventurat e lepurushit kureshtar, i cili s'mund t'i rezistojë tundimit për të hyrë në kopshtin e zotit McGregor. Aty nis një aventurë plot humor, pak rrezik dhe me shumë situata që i bëjnë fëmijët të qeshin... por edhe të reflektojnë.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- mësimet morale - pasojat e zgjedhjeve, përgjegjësia dhe ndershmëria;
- zhvillimin e empatisë - fëmijët identifikohen me kureshtjen dhe gabimet e Piterit;
- leximin aktiv - i përshtatshëm për klasën, për lexim në grup apo për lexim familjar para gjumit.

Drenusha Zajmi-Hoxha

Bletëzat

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autore: Drenusha Zajmi-Hoxha

Bletëzat

Ky libër i fton fëmijët të hyjnë në një botë ku do të qeshin, të imagjinojnë dhe të krijojnë pa fund! Libri përbëhet nga poezi plot humor e fantazi nëpër mendimet, lojërat dhe ëndrrat e fëmijëve. Çdo varg e rimë nxit kureshtjen, ndërsa ilustrimet e ngrohta u japin jetë poezive dhe e bëjnë leximin shumë më atraktiv.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- orët e leximit letrar, duke e çuar fëmijën nga fjala tek imazhi;
- zhvillimin e aftësive gjuhësore përmes vargjeve të lehta për t'u mbajtur në mend;
- nxitjen e fantazisë, sepse fëmijët mësojnë të krijojnë histori e botë të tyre.

Bedri Dedja

Përralla popullore mbi kafshët

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Bedri Dedja

Përralla popullore mbi kafshët

Një përmbledhje që sjell mençurinë popullore në gjuhën që fëmijët e duan: atë të kafshëve që flasin! Bedri Dedja zgjedh 10 përralla të shkurtra, të këndshme dhe plot jetë, ku personazhet japin mësim për miqësinë, zgjuarsinë dhe sjelljen e mirë. Fëmijët do t'i duan shumë, sepse rrëfimi vjen nga këndi i një bote që e kuptojnë natyrshëm.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- mësimet morale të qarta, të përshkuara nga situata të njohura për fëmijët;
- zhvillimin e të menduarit kritik, duke diskutuar: *kush kishte të drejtë? çfarë do bëje ti?*;
- mësimin e traditës sonë letrare, në formën më të dashur - përrallën.

vëllezërit Grim

Rrëfenja

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autorë: Vëllezërit Grim
Përktheu: Orjela Stafasani

Rrëfenja

Përralla klasike që kanë rritur breza të tërë... tani të përzgjedhura me kujdes për lexuesit më të vegjël! Nga kecat e mashtruar nga ujku, te miu dhe maçoku që mësohen me shoqërinë, çdo rrëfenjë sjell fantazinë dhe misterin karakteristik të vëllezërve Grim, por në një formë të thjeshtë për fëmijët që sapo kanë nisur të lexojnë.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- zhvillimin e aftësive të para të leximit, sepse tekstet janë të shkurtra, të qarta dhe të strukturuar;
- njohjen me klasiken, një bazë që çdo fëmijë duhet ta ketë;
- mësimet morale për trimërinë, zgjuarsinë dhe besimin, që mbeten gjatë në kujtesë.

Charles Perrault

Maçoku me çizme dhe përralla të tjera

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Charles Perrault
Përktheu: Eqrem Basha

Maçoku me çizme dhe përralla të tjera

Një histori plot humor e zgjuarsi, që i mëson fëmijët se fati i mirë nuk vjen gjithmonë nga pasuria... por nga ideja e zgjuar! Kur vëllait të vogël i bie hise një maçok, askush nuk e mendon se kjo kafshë do të kthehet në aleatin e tij më të fuqishëm. Me zgjuarsi, marrëzi të ëmbël dhe plane të pazakonta, Maçoku me çizme i hap dritare të reja suksesit të tij - deri në oborrin mbretëror.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:


- të nxitur besimin te vetja, sepse edhe gjërat e vogla sjellin ndryshime të mëdha;
- zhvillimin e imagjinatës, përmes situatave plot humor e aventura;
- t'i mësuar fëmijët ta vlerësojnë mençurinë mbi forcën.



Klasa e dytë

Seria e lektyrave shkollore për klasën e dytë përbëhet nga pesë tituj, që kombinojnë autorët më të famshëm botërorë për fëmijë me ata shqiptarë. Secili libër përmban aparaturën didaktike e fjalorthin shpjegues, të cilët i ndihmojnë fëmijët ta kuptojnë përmbajtjen dhe t'i përmirësojnë aftësitë e tyre gjuhësore, si dhe ilustrime origjinale për ta bërë më të këndshëm leximin.





Bedri Dedja

Shkolla e pyllit

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Bedri Dedja

Shkolla e pyllit

Një tregim argëtues ku të gjitha kafshët e pyllit, nga më të voglat te më të mëdhatë, mësojnë se shkolla është një vend ku të gjithë janë të mirëpritur dhe të vlefshëm. Në këtë libër të mrekullueshëm, Bedri Dedja i mbledh të gjitha kafshët e pyllit në shkollë, ku dallimet shndërrohen në pasuri dhe secili zbulon talentet e veta. Me shumë humor dhe situata të pazakonta, fëmijët mësojnë rëndësinë e edukimit dhe të formimit personal.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- edukim mbi tolerancën dhe diversitetin;
- motivim për të shkuar me dëshirë në shkollë;
- mësimet sociale-emocionale për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

Agim Deva

Vjersha

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Agim Deva

Vjersha

Krijime me fantazi të jashtëzakonshme e lojë gjuhësore - pikërisht ajo që i duhet një fëmije të klasës së dytë! Agim Deva sjell një përmbledhje vjershash të paharrueshme, si: “Biçikleta prej çokollate”, “Fjalët”, “Treni” e shumë të tjera. Çdo poezi hap një dritare të re drejt imagjinatës, duke nxitur krijimtarinë dhe dashurinë për fjalën artistike.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- lexim me zë në klasë dhe ushtrime dëgjimi;
- zhvillimin e gjuhës përmes rimave e figurave letrare të thjeshta;
- nxitjen e imagjinatës dhe të mendimeve kreative.

Margery Williams

Lepurushi prej pushi

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autore: Margery Williams
Përktheu: Orjela Stafasani

Lepurushi prej pushi

Një nga historitë më prekëse për fuqinë e dashurisë dhe magjinë e të qenit i Vërtetë. Ky libër klasik sjell aventurën emocionale të një lepurushi prej lodre, që ëndërron të bëhet i gjallë, i Vërtetë - dhe e zbulon se kjo ndodh vetëm kur je i dashur me zemër. Një mesazh i përjetshëm që fëmijët e kuptojnë menjëherë, sepse secili ka një lodër që e do.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- diskutime mbi empatinë, kujdesin dhe emocionet;
- aktivitetet e klasës mbi objektet e dashura dhe kujtimet personale;
- edukimin emocional për pranimin e ndryshimeve dhe të sfidave.

Karel Čapek

Përralla e postierit

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Karel Čapek
Përktheu: Eqrem Basha

Përralla e Postierit

Një histori plot surpriza dhe emocione - e krijuar për të pasur vëmendjen e fëmijëve nga faqja e parë deri tek e fundit. Karel Čapek-u sjell një përrallë të mrekullueshme ku një postier i zakonshëm udhëton në botën e fantazisë për të dërguar një letër të veçantë. Ngjarjet e pazakonta, situatat komike dhe mesazhet etike e bëjnë këtë libër një mjet të shkëlqyeshëm për zhvillimin e imagjinatës së fëmijëve.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- t'i bërë fëmijët ta duan leximin e ngjarjeve më të gjata;
- diskutime mbi etikën, përgjegjësinë dhe mirësinë;
- ushtrime kreative si: “ku do ta çojë ti letrën e radhës?”.

Hans Christian Andersen

Përralla të zgjedhura

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Hans Christian Andersen

Përralla të zgjedhura

Me stilin e tij unik, Anderseni u prezanton fëmijëve të klasës së dytë botë të mbushura me ndjenja dhe mësimë të vyeshme. Kjo përmbledhje përfshin disa nga përrallat më të dashura të autorit legjendar, të njohura për emocionet e forta, konfliktet tipike dhe mesazhet morale mbi mirësinë, guximin, besimin dhe vetëvlerësimin që mbeten përgjithmonë në mendjet e fëmijëve.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:


- edukimin mbi vlerat dhe virtytet njerëzore;
- zhvillimin e aftësisë për të interpretuar situata morale;
- hyrjen në botën klasike të letërsisë me gjuhë të kuptueshme për moshën.



Klasa e tretë

Seria e lektyrave shkollore për klasën e tretë përbëhet nga pesë tituj, që kombinojnë autorët më të famshëm botërorë për fëmijë me ata shqiptarë. Secili libër përmban aparaturën didaktike e fjalorthin shpjegues, të cilët i ndihmojnë fëmijët ta kuptojnë përmbajtjen dhe t'i përmirësojnë aftësitë e tyre gjuhësore, si dhe ilustrime origjinale për ta bërë më të këndshëm leximin.





Rudyard Kipling
*Si u bënë kafshët
siç janë sot?*

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Rudyard Kipling
Përktheu: Orjela Stafasani

Si u bënë kafshët siç janë sot?

Një udhëtim plot fantazi, humor dhe çudi, ku Rudyard Kiplingu u përgjigjet pyetjeve që fëmijët gjithmonë bëjnë: “Po si u bë elefanti me hundë kaq të gjatë?” ose “Pse zebra ka vija të bardha e të zeza?”. Me stilin e tij lozonjar, autorit i pëlqen t’u flasë drejtpërdrejt fëmijëve, sikur t’i kishte përballë, duke i futur mes tregimeve plot ritëm, lojëra fjalësh dhe personazhe komike që sfidojnë imagjinatën.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- zhvillimin e imagjinatës dhe të menduarit krijues;
- t’i afruar fëmijët me letërsinë klasike përmes humorit;
- shpjegime zbavitëse që nxisin kureshtjen e fëmijëve në mënyrë të natyrshme.

Gianni Rodari

Shigjeta e kaltër

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Gianni Rodari
Përktheu: Orjela Stafasani

Shigjeta e kaltër

Një aventurë e ngrohtë festash, ku te lodrat “zgjohet” vetëdëshira për t’u nisur drejt fëmijëve që i presin.

Në udhëtimin e tyre drejt djaloshit Françesko, ato përballen me sfida, pengesa, takime të çuditshme dhe momente komike - gjithçka që e bën këtë histori një rrëfim të paharrueshëm për miqësinë, këmbënguljen dhe gëzimin që sjellin dhuratat.


Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- kultivimin e empatisë dhe të solidaritetit;
- rritjen e motivimit për të lexuar gjatë festave;
- diskutime mbi dëshirat, dhuratat dhe mirënjohjen.

Bedri Dedja

Kallëzimet e gjyshe Pastërttores

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Bedri Dedja

Kallëzimet e gjyshe Pastërtores

Një libër plot ngjarje të vogla dhe situata komike, ku fëmijët mësojnë për higjienën, pastërtinë dhe disiplinën në mënyrë të natyrshme. Historitë tregojnë se si zakonet e mira dhe kujdesi për veten nuk janë të mërzitshme, por mund të jenë plot humor dhe argëtim, duke e bërë krijimin e shprehive të mira pjesë të fëmijëve në një moshë të tillë.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- të kuptuarit e rëndësisë së higjienës dhe të pastërtisë;
- mësimin e disiplinës dhe sjelljeve të mira në përditshmëri;
- reflektimin mbi përgjegjësitë personale dhe respektin për rregullat.

Mark Krasniqi

Posta e porositur

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Mark Krasniqi

Posta e porositur

Gjatë leximit të përmbledhjes me vjersha “Posta e porositur”, do të bëheni pjesë e botës së magjishme të kafshëve që kanë zërin e tyre... por edhe humorin. Do të mësoni më shumë për to e do të argëtoheni me bëmat e tyre.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- interpretim dhe lojëra ritmike;
- njohje me botën e poezisë përmes vargjeve të poetit të mirënjohur;
- nxitje të imagjinatës dhe diskutim në klasë.

carlo collodi

Aventurat e Pinokut

Historia e një marionete

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Carlo Collodi
Përktheu: Orjela Stafasani

Aventurat e Pinokut

Historia e Pinokut, kukullës prej druri me zemër të mirë, e sjell mësimin për rëndësinë e përgjegjësisë, të sinqeritetit dhe të vepruarit me kujdes. Përmes gabimeve të tij, të qeshurave dhe aventurave të pazakonta, fëmijët kuptojnë se çdo veprim ka pasoja dhe se të mësuarit nga gabimet është pjesë e rritjes.



Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- mësimin e përgjegjësive që u takojnë fëmijëve;
- kuptimin e rëndësisë së sinqeritetit dhe të veprimeve të mira;
- nxitje të imagjinatës dhe diskutim në klasë.

Klasa e katërt

Seria e lektyrave shkollore për klasën e katërt përbëhet nga gjashtë tituj, që kombinojnë autorët më të famshëm botërorë për fëmijë me ata shqiptarë. Secili libër përmban aparaturën didaktike e fjalorthin shpjegues, të cilët i ndihmojnë fëmijët ta kuptojnë përmbajtjen dhe t'i përmirësojnë aftësitë e tyre gjuhësore, si dhe ilustrime origjinale për ta bërë më të këndshëm leximin.





waldemar Bonsels

Bleta Maja dhe aventura e saj

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Waldemar Bonsels
Përktheu: Alida Çepele

Bleta Maja dhe aventurat e saj

Një aventurë plot ngjyra ku Maja, bleta e vogël dhe e guximshme, eksploron botën jashtë kolonisë së saj. Takimet me krijesa të ndryshme dhe sfidat që përballon i mësojnë fëmijët për kurajën, bashkëpunimin dhe këmbënguljen, ndërsa zbulojnë bukuritë e natyrës.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- zhvillimin e imagjinatës dhe të kreativitetit;
- mësimin e vlerave personale dhe të bashkëpunimit;
- lexim argëtues dhe edukativ në të njëjtën kohë.

Lewis Carroll

Aventurat e Lizës në Botën e Çudirave

ME APARATURË DIDAKTIKE




Autor: Lewis Carroll
Përktheu: Orjela Stafasani

Aventurat e Lizës në Botën e Çudirave

Një rrëfim plot magji dhe çudi, ku Liza përballet me situata të paparashikueshme dhe personazhe të mrekullueshme, duke zhvilluar kureshtjen, guximin dhe zgjuarsinë e saj. Libri nxit imagjinatën dhe fton fëmijët të mendojnë ndryshe, të eksperimentojnë dhe ta zbulojnë botën në mënyrë kreative.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- zhvillimin e imagjinatës dhe të mendimit krijues;
- mësimin e vlerave personale, si: kureshtja, guximi etj.;
- lexim argëtues dhe aktiv, individual ose në grup.



Autor: Ymer Elshani

Udhëtimi i Pikëpyetjes (Tregime të zgjedhura)

Një përmbledhje magjike me 25 tregime të ndryshme, ku fëmijët takojnë personazhe si Cinilinoja nga planeti Ështëlarg, vizitojnë një mbretëri tërësisht të ndërtuar nga çokollata dhe zbulojnë botë plot shenja pikësimi, aventura dhe ngjarje fantastike. Çdo tregim nxit kureshtjen, imagjinatën dhe dëshirën për të eksploruar botën rreth tyre.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- zhvillimin e imagjinatës dhe të kureshtjes;
- mësimin e vlerave personale, si: miqësia dhe guximi;
- lexim argëtues dhe edukativ, individual ose në grup.

Naum Prifti

Legjenda dhe rrëfime për Skënderbeun

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Naum Prifti

Legjenda dhe rrëfime për Skënderbeun

Një përmbledhje rrëfimesh dhe legjendash që sjellin historinë e heroit kombëtar Gjergj Kastrioti - Skënderbeu në një formë të thjeshtë dhe tërheqëse për fëmijët. Ngjarjet epike tregojnë trimërinë, mençurinë dhe strategjinë e tij, duke e bërë historinë e arbërve të gjallë dhe të afërt për lexuesit e vegjël.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- mësimin e historisë sonë - ndonëse libër letrar, ai sjell të dhëna të vlefshme për historinë e popullit tonë;
- diskutim mbi historinë e shqiptarëve dhe kultivimin e vetëdijes dhe të dashurisë kombëtare te fëmijët.

Rudyard Kipling

Libri i Xhunglës

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Rudyard Kipling
Përktheu: Orjela Stafasani

Libri i Xhunglës

Një histori e jashtëzakonshme e një fëmije të quajtur Mogli, i cili rritet e mëson të jetojë në mes të Xhunglës, duke përballuar sfida dhe duke zbuluar rëndësinë e guximit, të besnikërisë dhe të respektit për krijesat e tjera. Tregimet ndërthurin fantazinë me mësimet të thella për rritjen dhe miqësinë, duke e bërë çdo aventurë të paharrueshme për fëmijët.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- zhvillimin e imagjinatës dhe të mendimit simbolik;
- të mësuar rreth kafshëve të ndryshme të Xhunglës;
- forcimin e vlerave të guximit dhe të besnikërisë.

Rudyard Kipling
Libri i dytë
i Xhunglës
ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Rudyard Kipling
Përktheu: Albion Zifla

Libri i dytë i Xhunglës

Tashmë, në librin e dytë, Mogli rritet e mëson të udhëheqë, t'i bashkojë krijesat e Xhunglës dhe të përballë me sfida më të rënda. Kjo vazhdimësi tregon maturinë, përgjegjësinë dhe bashkëpunimin, duke dhënë një shembull të fuqishëm për lexuesit e vegjël.


Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- zhvillimin e përgjegjësisë dhe të aftësive udhëheqëse;
- nxitjen e guximit dhe të bashkëpunimit;
- lexim reflektues dhe kuptim të thellë të mesazheve.

Klasa e pestë

Seria e lektyrave shkollore për klasën e pestë përbëhet nga pesë tituj, që kombinojnë autorët më të famshëm botërorë për fëmijë me ata shqiptarë. Secili libër përmban aparaturën didaktike e fjalorthin shpjegues, të cilët i ndihmojnë fëmijët ta kuptojnë përmbajtjen dhe t'i përmirësojnë aftësitë e tyre gjuhësore, si dhe ilustrime origjinale për ta bërë më të këndshëm leximin.





Ezopi
Përrallëza

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Ezopi

Përrallëza

Përmbledhje përrallëzash të mençura, ku fëmijët mësojnë për mirësinë, ndershmërinë dhe guximin përmes ngjarjeve jashtëzakonisht interesante e komike të kafshëve. Historitë e thjeshta, por të thella, i ndihmojnë fëmijët të reflektojnë mbi veprimet e tyre dhe ta kuptojnë botën përreth.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- zhvillimin e vlerave morale dhe të përgjegjësisë;
- ndërtimin e mendimit kritik dhe reflektues;
- lexim aktiv dhe diskutime mbi mesazhet morale.

Rrahman Dedaj

Medaljoni

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Rrahman Dedaj

Medaljoni

Një përmbledhje tregimesh plot aventura dhe personazhe fantastike, nga vajza që ndihmon gjyshin te maçoku që ëndërron shkollën. Tregimet nxisin imagjinatën, kureshtinë dhe vlerat personale, si: mirësia, bashkëpunimi dhe kreativiteti.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- zhvillimin e imagjinatës dhe të kreativitetit;
- mësimin e vlerave personale dhe sociale;
- lexim argëtues dhe edukativ.

Qamil Batalli

Agimet e kaltra

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Qamil Batalli

Agimet e kaltra

Një histori frymëzuese për një djalosh që ndjek ëndrrën e tij për të shpikur një makinë, duke u përballur me pengesa dhe sfida të ndryshme që i dalin përpara. Ky libër frymëzon fëmijët të besojnë tek idetë e tyre dhe të punojnë me zell për t'i realizuar ëndrrat.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- nxitjen e mendimit krijues;
- forcimin e vetëbesimit dhe të këmbënguljes;
- diskutime në klasë ose në familje.

Vehbi Kikaj

Sarajet e bardha

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Vehbi Kikaj

Sarajet e bardha

Një histori delikate që tregon botën e brishtë të vogëlushes Mirushe, protagonistes së këtij libri, e cila përjeton një pikëllim në një familje të trazuar.

Por... ja që Mirushja është heroína e ngjarjes, sepse ajo bëhet një urë lidhëse mes prindërve të saj.


Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- zhvillimin e empatisë dhe të ndjeshmërisë;
- lexim reflektues dhe diskutime në klasë ose në familje.

Zhyl Vern

Dy vjet pushime

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Zhyl Vern
Përktheu: Nazim Lleshi

Dy vjet pushime

Historia e një grupi djemsh që mbeten vetëm në një ishull të panjohur, ku mësojnë të bashkëpunojnë, të mbijetojnë dhe të marrin vendime të rëndësishme në grup. Autori na paraqet një aventurë që nxit guxim, mendim kritik dhe bashkëpunim, duke i bërë fëmijët pjesë të udhëtimit dhe të rritjes së personazheve.

Ky libër është i shkëlqyeshëm për:

- zhvillimin e imagjinatës dhe të kureshtjes;
- mësimin e vlerave të bashkëpunimit dhe të solidaritetit;
- diskutime me shokët dhe shoqet.

LEKTYRAT 6-9

Seria e lektyrave shkollore për klasat 6-9 është konceptuar për nxënës që hyjnë në një fazë më të pjekur të leximit dhe të kuptimit. Kjo seri ofron tekste të përzgjedhura me kujdes, të shoqëruara me fjalorth shpjegues, aparaturë didaktike dhe ilustrime origjinale që ndihmojnë në përvetësimin e përmbajtjes. Çdo libër synon të zhvillojë jo vetëm aftësitë gjuhësore, por edhe të nxisë mendimin kritik dhe kënaqësinë e leximit.



Në këtë seri bashkohen autorë shqiptarë, si: Ndre Mjedja, Migjeni, Naum Prifti, Rifat Kukaj, Rrahman Dedaj etj. dhe shkrimtarë të njohur botërorë, si: Frances Hodgson Burnett, Charles Dickens, Daniel Defoe, Zhyl Vern, Mark Twain, Lois Lowry etj., duke u ofruar nxënësve një përvojë të pasur letrare. Temat janë më të thelluara dhe më pranë botës së tyre, duke i përgatitur, kështu, nxënësit për nivele më të larta të të nxënit.



Klasa e gjashtë

Seria e lektyrave shkollore për klasën e gjashtë përbëhet nga tetë tituj, që kombinojnë autorët më të famshëm botërorë për fëmijë me ata shqiptarë. Secili libër përmban aparaturën didaktike e fjalorthin shpjegues, të cilët i ndihmojnë fëmijët ta kuptojnë përmbajtjen dhe t'i përmirësojnë aftësitë e tyre gjuhësore, si dhe ilustrime origjinale për ta bërë më të këndshëm leximin.





Frances Hodgson Burnett

Kopshti sekret

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autore: Frances Hodgson Burnett
Përktheu: Ledia Dushi

Kopshti sekret

“Kopshti sekret” është një histori plot mister dhe magji, ku Meri, një vajzë e vetmuar, zbulon rastësisht një derë të fshehtë që çon në një kopsht të harruar prej kohësh. Ndërsa përpiqet ta rikthejë në jetë, ajo zbulon sekrete të çuditshme, krijon miqësi të papritura dhe përballet me një mister edhe më të madh brenda shtëpisë së vjetër. Me çdo ditë që kalon, jo vetëm kopshti ndryshon, por edhe vetë Meri. *Por, a është magjia e kopshtit ajo që i transformon të gjithë, apo ka diçka më të thellë që fshihet brenda tij?*

Rrahman Dedaj

Misteret e radiostacionit EM-2

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Rrahman Dedaj

Misteret e radiostacionit EM-2

“Misteret e radiostacionit EM-2” është një përmbledhje tregimesh nga krijimtaria e Rrahman Dedajt, që përfshin tregime të zgjedhura nga “Zogu dhe kulla” dhe vepra të tjera të tij. Në këto tregime takojmë fëmijë kureshtarë, personazhe të ndjeshme plot imagjinatë, të cilat përballen me situata të thjeshta, ku fshihen kuptime të thella.

Me një gjuhë të pasur dhe të afërt për lexuesin e ri, autori ndërton një botë ku fantazia dhe realiteti ecin dorë për dorë.

Rifat Kukaj

Ujku me kamerë

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Rifat Kukaj

Ujku me kamerë

Libri “Ujku me kamerë” është përmbledhje tregimesh të shkurtra me kafshë, shpendë, elemente të natyrës, fëmijë të vegjël etj., të cilat, përmes situatave interesante dhe humorit të këndshëm, përcjellin mësimet të vlefshme për jetën. Këto personazhe interesante përballen me sfida të ndryshme, gjatë të cilave tregohen të zgjuara, të ndershme e të guximshme, duke i nxitur kështu lexuesit të reflektojnë, në të vërtetë, për sjelljen dhe vlerat njerëzore.

Lois Lowry

Bartësi

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autore: Lois Lowry
Përktheu: Meliza Krasniqi

Bartësi

Në romanin “Bartësi” rrëfëhet historia e Xhonasit, një djali që jeton në një shoqëri ku gjithçka është e rregulluar me kujdes dhe ku njerëzit nuk kanë mundësi zgjedhjeje, kujtime apo emocione. Kur ai përzgjidhet për të marrë një detyrë të veçantë, fillon të zbulojë të vërteta të fshehta për botën ku jeton. Përmes mësimave, ai nis të njohë emocionet, dashurinë, dhimbjen dhe bukurinë e përvojave njerëzore. Ky libër ngre pyetje të rëndësishme për lirinë, zgjedhjen dhe vlerën e të qenit ndryshe.

Charles Dickens

Oliver Tuisti

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Charles Dickens
Përktheu: Antonio Çikollari

Oliver Tuisti

Në këtë libër rrëfëhet historia e Oliver Tuistit, një djaloshi jetim, i cili rritet në varfëri të madhe, rrethuar nga njerëz të këqij që e keqtrajtojnë dhe i shkaktjnë vështirësi të shumta. Përkundër të gjithave, ai arrin të ruajë zemërbardhësinë, guximin dhe besimin te njerëzit e mirë, duke i kapërcyer, kështu, të gjitha pengesat dhe duke arritur, në fund, ta gjejë lumturinë.

Migjeni
Luli i vocërr

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Migjeni

Luli i Vocërr

“Luli i vocërr” është vepra më e njohur e Migjenit, në të cilën përfshihen tregime, novela, skica e vjersha me tema shoqërore. Pra, libri shpërfaq varfërinë shpirtërore e materiale në jetë, vuajtjet dhe vështirësitë e njerëzve. Madje drita bie edhe mbi fëmijët, nëpërmjet personazhit Luli i vocërr, ku tregohet se si varfëria ua pamundëson lumturinë e në njëfarë forme edhe realizimin e ëndrrave.

Mark Twain

Aventurat e Tom Sojerit

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Mark Twain
Përktheu: Elvana Zaimi-Tufa

Aventurat e Tom Sojerit

Në romanin “Aventurat e Tom Sojerit” rrëfëhet historia e Tomit, një djali të zgjuar, kureshtar dhe plot imagjinatë, që arrin ta shndërrojë çdo ditë të zakonit në aventurë të re. I rritur në një mjedis të vogël pranë lumit Misisipi, Tomi është fëmijë i lirë, i etur për zbulime dhe për aventura. Së bashku me shokët e vet, ai zbulon sekrete, përballet me frikëra të ndryshme dhe kalon nëpër situata të jashtëzakonshme, shpeshherë edhe qesharake, që e ndihmojnë të rritet e të kuptojë më mirë botën përreth.

Përmes aventurave, humorit dhe situatave të papritura, romani shpërfaq bukurinë e fëmijërisë dhe përcjell vlera të rëndësishme si miqësia, guximi e ndershmëria.

Wilson Rawls

Aty ku rritet fieri i kuq

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Wilson Rawls
Përktheu: Antonio Çikollari


Aty ku rritet fieri i kuq

Në romanin “Aty ku rritet fieri i kuq” rrëfëhet historia e Billit, një djali që jeton në fshat dhe ëndërron të ketë dy qen gjuetie. Me këmbëngulje, punë dhe sakrificë, ai arrin ta realizojë ëndrrën e tij. Megjithatë, gjatë fëmijërisë së vet, Billi përballet me sfida të shumta, nga të cilat nxjerr mësimet jetësore. Ai mëson ta vlerësojë dhe ta kultivojë dashurinë për njerëzit e kafshët, të përballet me vdekjen si një nga përvojat më të dhimbshme në jetën e njeriut, si dhe të marrë përgjegjësi e të luftojë për gjërat dhe njerëzit që do.

Klasa e shtatë

Seria e lektyrave shkollore për klasën e shtatë përbëhet nga tetë tituj, të përzgjedhur nga letërsia shqipe dhe ajo botërore, që u ofrojnë nxënësve tema, personazhe dhe ide të rëndësishme për moshën e tyre. Çdo libër përmban aparaturën didaktike dhe fjalorthin shpjegues, të cilët ndihmojnë në të kuptuarit më të thellë të veprës, pasurimin e fjalorit dhe zhvillimin e shkathtësive të leximit kritik. Po ashtu, librat janë të pajisur me ilustrime origjinale që e bëjnë leximin më tërheqës dhe më të këndshëm.





Rifat Kukaj

Dita e xhufkave

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Rifat Kukaj

Dita e xhufkave

Në romanin “Dita e xhufkave” të Rifat Kukajt rrëfëhet udhëtimi i Fatosit dhe i Kapedanit, të njohur si Ujku i detit, bashkë me Pulëbardhën dhe Delfinin, të cilët nisen në kërkim të Ujdhesës së Luleve. Gjatë lundrimit, ata përballen me rreziqe të ndryshme dhe përjetojnë aventura që i afrojnë gjithnjë e më shumë drejt qëllimit të tyre. Udhëtimi i tyre nuk është vetëm kërkim i një vendi të largët, por edhe mision për të përhapur paqen, dashurinë dhe mirëkuptimin mes njerëzve. Përmes të rrëfyerit të ngrohtë e me humor, Rifat Kukaj arrin të krijojë botën që çdo fëmijë ëndrron; të mbushur me mirësi e dashuri.

Ndre Mjedja

Andrra e jetës

ME APARATURË DIDAKTIKE



Autor: Ndre Mjedja

Andrra e jetës

Libri “Andrra e jetës” është për zgjedhje e krijimtarisë poetike të Ndre Mjedjes, ku shpërfaqet jeta e njerëzve të thjeshtë, dashuria për familjen e atdheun, bukuria e natyrës shqiptare dhe përkushtimi ndaj gjuhës shqipe. Përmes personazheve, ngjarjeve dhe figurave historike, poeti shpreh dhembshurinë për vuajtjet e njeriut, krenarinë për të kaluarën dhe shpresën për të ardhmen e vendit. Me gjuhë të pasur poetike, Mjedja krijon vargje që ngjallin emocion te lexuesi, njëhërësh që ftojnë të zbulojë botën shpirtërore, historinë dhe vlerat e popullit shqiptar.

Ana Frank

Ditari i Ana Frankut


ME APARATURË DIDAKTIKE



Autore: Ana Frank
Përktheu: Ervin Lani

Ditari i Ana Frankut

Në veprën “Ditari i Ana Frankut” shtjellohet historia e Anës, një vajze hebreje që, gjatë Luftës së Dytë Botërore, detyrohet të fshihet së bashku me familjen e saj për t’u shpëtuar përndjekjeve naziste. E fshehur për më shumë se dy vjet në një hapësirë të mbyllur në Amsterdam, Ana, në ditarin e saj, i shpreh mendimet, frikërat, ëndrrat dhe shpresat e një vajze që dëshiron të jetojë si gjithë bashkëmoshatarët e saj. Përmes shkrimeve të saj të singerta, ajo shpërfaq jo vetëm vështirësitë e një kohe të errët, por edhe forcën, optimizmin dhe dëshirën e madhe për një botë më të mirë. Ditari i saj mbetet dëshmi prekëse e vuajtjeve të njerëzve, veçan hebrejve, gjatë luftës, njëherësh zë i fuqishëm i një vajze që, edhe në rrethana të jashtëzakonshme, nuk humbi besimin te njerëzit dhe te jeta.



Autor: Daniel Defoe
Përktheu: Albion Zifla

Robinson Kruzo

Në romanin “Robinson Kruzo” të Daniel Defoit rrëfëhet historia e Robinsonit, një të riu që, pas një lundrimi të rrezikshëm në det, përfundon i vetëm në një ishull të shkretë. Duke u përballur me vetminë dhe vështirësitë e jetës në këtë ishull, ai mëson të kujdeset për veten, të ndërtojë strehim dhe të sigurojë gjithçka që i nevojitet për të mbijetuar. Pra, falë dëshirës së madhe për jetën, Robinsoni arrin të bëjë jetë thuajse normale në ishull, ndaj përmes këtij rrëfimi plot aventura, lexuesi mëson dhe reflekton për vetminë, marrëdhënien e njeriut me natyrën dhe vullnetin e fortë të tij për të mbijetuar.

Scott O'Dell

Ishulli i delfinëve të kaltër

ME APARATURË DIDAKTIKE

duk²gjini

7

Autor: Scott O'Dell
Përktheu: Bojana Spahija

Ishulli i delfinëve të kaltër

Në romanin “Ishulli i delfinëve të kaltër” të Skot O’De-llit rrëfëhet historia e Karanas, një vajze të re që mbetet e vetme në një ishull të largët pas largimit të fisit të saj. E përballur me vetminë, rreziqet dhe vështirësitë e jetës në natyrë, ajo mëson të mbijetojë falë zgjuarsisë, guximit dhe njohurive të trashëguara nga populli i vet. Gjatë viteve të kaluara në ishull, Karana krijon lidhje të veçantë me natyrën dhe me kafshët përreth, duke zbuluar forcën e brendshme dhe aftësinë për t’u përshtatur me çdo rrethanë.

Zhyl Vern

Rreth botës për 80 ditë

ME APARATURË DIDAKTIKE

duk gjini

7

Autor: Zhyl Vern
Përktheu: Ergisa Bebja

Rreth botës për 80 ditë

Në romanin “Rreth botës për 80 ditë” të Zhyl Vernit rrëfëhet aventura e jashtëzakonshme e Fileas Fogut, një zotëri anglez i përpiktë dhe i qetë, i cili vë bast se mund ta përshkojë botën për vetëm tetëdhjetë ditë. Së bashku me shërbëtorin e vet besnik, Paspartinë, ai nisët në një udhëtim të gjatë nëpër vende të ndryshme të botës, ku përballet me pengesa, rreziqe e ndodhi fort të papritura. Gjatë këtij udhëtimi, personazhet, e bashkë me to edhe lexuesi, njohin kultura të ndryshme, zbulojnë vende të largëta dhe provojnë se falë vendosmërisë e guximit mund të kapërcet çdo pengesë e të arrihet çdo qëllim. Nëpërmjet përshkrimeve të gjalla të Zhyl Vernit, lexuesi jo vetëm përjeton aventurën, por edhe zbulon vetë botën.

Naim Frashëri

Historia e Skënderbeut

ME APARATURË DIDAKTIKE

duk²gjini

7

Autor: Naim Frashëri

Historia e Skënderbeut

Në librin “Historia e Skënderbeut” të Naim Frashërit rrëfëhet jeta e Gjergj Kastriotit që nga fëmijëria e tij, vitet e kaluara larg atdheut dhe kthimi në Krujë për të udhëhequr luftën e shqiptarëve kundër pushtuesit osman. Përmes këtij rrëfimi, autori sjell momentet më të rëndësishme të jetës së Skënderbeut, përballjet e tij me armiqtë, betejat e shumta dhe përpjekjet për bashkimin e princërve shqiptarë. Skënderbeu paraqitet jo vetëm si luftëtar i madh, por njëherësh edhe si udhëheqës i mençur, i lidhur fort emocionalisht me popullin dhe me vendin e vet.



Autor: Naum Prifti

Kërkohet një thesar (Tregime të zgjedhura)

Në përmbledhjen e tregimeve “Kërkohet një thesar” të Naum Priftit jepen ngjarje dhe përjetime të lidhura ngushtë me natyrën dhe botën e gjallë. Përmes përshkrimeve të pasura të maleve, të pyjeve, të kafshëve të egra dhe të peizazheve shqiptare, autori sjell pamje tërheqëse të mjedisit ku zhvillohen ngjarjet. Në këto tregime paraqiten marrëdhënia e njeriut me natyrën, bukuria dhe vështirësitë e jetës në mal, si dhe kujdesi për të kuptuar e ruajtur botën që na rrethon.







www.dukagjinibotime.com



info@dukagjinipublishing.com



049 - 750 - 012



@dukagjinipublishinghouse



@dukagjinipublishinghouse



Dukagjini Publishing House



@dukagjiniPH



Download on the
App Store

GET IT ON
Google Play



Libraria "Dukagjini" mundëson transportin
në Shqipëri, Evropë dhe ShBA. Për porosi,
skano QR code-in.

Shtëpia botuese "Dukagjini"
Xhevdet Doda, Dukagjini Center
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës